



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 10/17
Prishtinë, më 08.12.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajqi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Mytaher Haskuka dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi Zëvendës-Ministër i Financave (MF), Enis Spahiu nga MF, Kreshnik Gashi Kryetar i Bredit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Fatmir Gërvalla nga ARKEP, Valbon Bytyqi nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Buajr Sejdiu nga ZKA, Ismet Krasniqi – Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit, Nora Jusufi dhe Berat Thaqi nga Instituti GAP.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 14.11.2017 dhe 22.11.2017;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2017;
6. Shqyrtimi i Propozimeve të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi që rendi i ditës miratohet njëzëri.

Mërgim Lushtaku - e kam një vëretje te fjalimi im në procesverbalin e dt. 22.11.2017, që një fjalë nuk e kam thënë dhe është mirë me ndryshu në reshtin e dytë fjala “politizuar” të bëhet “prioritizuar”.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 14.11.2017 dhe 22.11.2017

Kryetari – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet me vërejtjet e deputetit Mërgim Lushtaku në procesverbalin e datës 22.11.2017.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080

Fatmir Gashi - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit synon rregullimin e kuadri ligjor për investimin e mjeteve të privatizimit në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës, trajtimin e fondeve të agjencisë së ndryshimeve operative. Dispozitat përkatëse për rregullimin e fondeve të AKP-së do të mundsojnë transferimin e një pjese të mjeteve të privatizimit nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit për në fondet e konsoliduara të Republikës së Kosovës, këto mjete do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Ju e dini që në AKP ka filluar procesi i likuidimit të aseteve të ndërmarrjeve dhe deri tash sa kam unë informata ku 501 ndërmarrje e kanë kryer në mënyrë teknike procesin e likuidimit dhe ato pastaj shkojnë në Dhomën e Veçantë në Gjykatën Speciale, e cila merr vendim për secilin kërkesë dhe për secilin pagesë. Pasi që të kryhet procesi i likuidimi të gjitha kërkesat kreditore të cilat ekzistojnë aty mbesin diku rreth 370 milion, të cilat me ndryshim të këtij ligji të barten në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Përmes këtij ligji Qeveria e Kosovës shpronësuesve duhet tu paguaj një shumë të caktuar të mjeteve financiare të cilat janë të dedikuara për punëtorët që janë përfitues të këtyre mjeteve si dhe paguan tarifat të cilat i ka AKP-ja. Propozim tjetër i rëndësishëm në këtë projektligj është rregullimi i duhur i mandatit të drejtorëve të bordeve prej 4 vjetëve me të drejtë rizgjedhje si dhe vazhdimi i mandatit të drejtorëve deri në zgjedhjen e mandatimin e kandidaturës së re të Bordit të AKP-së nga Kuvendi i Kosovës. Në bazë të vlerësimit të Ministris së Financave zbatimi i këtij projektligji nuk do të sjell shtesë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës andaj ju rekomandoj ta votoni në parim këtë projektligj.

Kryetari - kam disa vëretje për termet e përdorura në projektligj dhe besoj që me ligj duhet të jem pak më të kujdesshëm. P.sh. kur thuhet që parat barten në Qeveri është mirë të thuhet që barten në Buxhetin e Republikës së Kosovës. E dyta ku është thënë se paratë e privatizimit përdoren për zhvillim ekonomik duhet të ndërrohet të thuhet për investime kapitale sepse zhvillimi ekonomik është gjithçka dhe duhet të jetë më e specifikuar për investime kapitale. E treta ka disa shpërputhje të emertimeve të ligjeve dhe ju lus që këto i rishikojmë edhe njëherë që të kemi kujdes p.sh.ligjet kanë emër të saktë dhe është mirë ti referohet në plot kuptimin e emrit. E katërta sa e di unë ligji nuk vlen për të kaluarën, por vlen për të ardhmen, ndërsa në paragrafin 4 të nenit 6 thuhet se ky vlen për shpronësimin në të kaluarën apo të ardhmen e pronave të ndërmarrjeve shoqërore. Qështja më e rëndësishme është paraparë me nenin 10 paragrafi 1 që flet për bordin e drejtorëve që mund ti përcaktojë me rregullore të veçantë vendimet që mirren me shumicë të kualifikuar, ndërkaq me ligjin bazik janë të parapara taksativisht vendimet e që miren me shumicë të kualifikuar.

Naser Osmani - tani jemi në një situatë ku e konsiderojë të domosdoshëm ndryshimin e ligjit për privatizimin, sidomos në kohën kur është bërë procesi i likuidimit gati në përfundim. Mua më intereson zv.Ministër a mjafton vetëm ndryshimi i ligjit të AKP-së apo duhet bërë ndryshimin e ligjit edhe për Dhomën e Veçantë që me mundur mi shfrytëzu mjetet qysh parashihen për investime kapitale?

Fatmir Gashi – sqaroi se në ligjin mbi AKP-në janë paraparë si ruhen mjetet dhe është shkruar decididisht që bartja e mjeteve, bëhet pasi që të kryhen të gjitha procedurat sipas vendimeve të Dhomës së Posaqme dhe ato që mbetin aty është paraparë me ligj një fond rezervë. Në rast se mjetet në fondin rezervë nuk mjaftojnë, Qeveria e merr përsipër që ta bëj pagesën apo ti kthej mjetet e tërhequra me prioritet. Dhoma e Posaqme ka për detyrë me krye likuidimin, me i marrë vendimet dhe më i vërtetu të gjitha obligimet që i kanë ndërmarrjet dhe kur mirren ato vendime paratë që mbetin janë të lira.

Kryetari - sa për informim në ligj e pash një nen të cilin e parasheh Qeveria me kthi mjete në qoftë se Dhoma e Veçantë e vlerëson se nuk janë të mjaftueshme. Edhe njëherë po themi ligji është i domosdoshëm dhe është i nevojshëm por ka defekte serioze në hartimin e tij, të cilat duhet mu korigjue.

Safete Hadërgjonaj - konsideroj që është një diçka e mirë që në fund të këtij viti po shqyrtohet ky projektligj dhe shpresoj që shumë shpejtë do të jetë në seancë plenare dhe të miratohet në lexim të parë dhe ne të kemi mundësin mandej si komision që të analizojmë projektligjin ku do të jenë pjesëmarrëse përfaqësuesit nga Ministria dhe AKP, ku do të na japin sqarimet e nevojshme për dispozitat dhe nenet e projektligjit dhe të gjitha vërejtjet që mund ti kemi, mund ti diskutojmë dhe të bëjmë ndryshimet e nevojshme. Ajo që kam vërejtur në projektbuxhetit për vitin 2018, mjetet që planifikohe të merren nga AKP, thujase në tërësi janë të orientuara në investimet kapitale dhe sipas projekteve të caktuara. Pra, rekomandojmë që të përkrahim miratimin e tij në parim në seancë plenare, pastaj do të kemi mundësi për analizimin dhe shqyrtimin më në detal dhe profesional në komision dhe të propozojmë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme me rastin e leximit të dytë të tij.

Kryetari - ne po e kalojmë një ligj për të cilin kemi pritur shumë dhe Kosova ka nevojë për paratë e fondit të privatizimit dhe shpresojmë që do ti adresojmë sa ma mirë dhe ti përdorim mjetet nga projektet kapitalet. Natyrisht se ne do ta analizojmë më detalisht në komision, vërejtjet që u ngriten dhe të tjera, dhe do të propozojmë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të projektligjit.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016

Kryetari – fillimisht e falendërojmë ekipin e Auditorit të Përgjithshëm që është përgjigjur ftesës për të prezantuar raportin e auditimit për Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare të Kosovës 2016. Pra sa herë që i kemi raporte financiare për trajtim në komision, do ta kemi të ftuar ekipin e Auditorit që ti jep vlerësimet e veta dhe të gjeturat. Raporti financiar i ARKPE-it pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar nga për vitin 2016 dhe të dhëna për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive të shpenzimeve, krahasimin me vitet paraprake si dhe të dhënat për të

hyrat e realizuar. Buxheti i shpenzuar sipas kategorive është: për pagat dhe mëditjet 95%, mallrat dhe shërbimet rriten 99%, shpenzimet komunale 94% dhe investimet kapitale 100%.

Kreshnik Gashi - në vitin 2016, Autoriteti ka pasur një buxhet të aprovuar prej 834.868 mijë euro dhe në total është realizuar 94.4% e buxhetit të planifikuar. Të hyrat e realizuara janë 4.787.451 milion euro. Sa i përket sfidave që ballafaqohet ARKEP-i me numër më të vogël të stafit dhe është përgjysmë më e vogël se agjencitë e tjera në rajon. Është diferencim i madhë në mes pagave të agjencive të ndryshme rregullatore në vend, dhe pagat e stafit të ARKEP-it janë më të ulëta se sa shumica e agjencive të tjera rregullatore dhe jemi duke u përballur me një shqetësim me ikjen e stafit të punëtorëve.

Valbon Bytyqi – në raportin e auditimit për ARKEP-in për vitin 2016, ne kemi dhënë një opinion të pa modifikuar në theksim të çështjes, dhe kjo ka të bëjë me mbivlerësimin e pasurisë jo kapitale nën 1000 mijë euro dhe nën vlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Qështjet e theksuara ishin: lloji i llogarisë së arkëtueshme ishte nënvlerësuar për 512.000 mijë euro sepse nga kjo llogari ishte prezantuar vetëm të arktueshme deri në fundvitin e vitit 2015 dhe nuk janë të përfshirë faturimet e vitit 2016 të cilat nuk janë inkasuar. Pasuria jo kapitale është mbivlerësuar për 18 mijë euro si rezultat i mungesave të vlerësimit vjetor të pasurisë. Përderi sa te qeverisja ARKEP-i kishte përgaditur planin e veprimit të zbatimit dhe rekomandimet nga Auditimi nga viti paraprak dhe gjithsej nga rekomandimet e dhëna dy ishin në zbatim ndërsa 3 janë në proces të zbatimit.

Edhe pse në bazë të buxhetit ARKEP nuk i plotëson kërkesat për me themel Njësi të Auditimit të brendshëm është vërejtur gadishmëria e tyre që me kërku një Auditimi të brendshëm nga njësi qendrore harmonizuese. Tek legjislacioni sekondar ARKEP-i nuk e ka aprovuar draft statutin e autoritetit dhe rregulloren e re të punës sepse siq kërkohet me legjislacionin përkatës. Të hyrat ishin inkasuar afro 5 milionë euro regjistrimi i tyre është në raste të caktuara dhe janë përcjell me vonesa. Te pagat e personelit kemi indetifikuar disa mangësi kryesisht kanë qenë të procesit të rekrutimi si dhe te mbajtja e pozitave në ushtrues detyre, një pozitë e tillë është kërkuar që nga muaji Mars 2016 duke e tejkaluar limitin e përcaktuar me rregulloren e ligjit civil. Në fusha tjera tek investimet kapitale për borxhet nuk janë të identifikuar dobësi.

Naser Osmani - a ka mundësi që të më tregoni se si po shkon rrjedha lidhur me realizimin e kodit të telefonisë dhe lidhur me marrëveshjen politike në realizimin e operatorit të ri?

Kryetari – lidhur me vonesën për miratimin draft statusit të Autoritetin, çfarë masa keni ndëmarrur ju si bord për të plotësuar këtë vërtetje me vend të paraqitur nga Auditori?

Kreshnik Gashi – në fakt me ndarjen e kodit të ri telefonik për Republikën e Kosovës në Dhjetor të vitit 2016, ARKEP ka përgaditur fondin e migrimit dhe ekzistuese në kodin telefonik +383 dhe ka përgaditur raportin kohor se kur duhet të ndodhë kjo. Afati kohor i paraparë edhe me rregulloren ndërkombëtare është 18 Muaj nga data e marrjes së kodit që efektivisht i bjen që të filloj nga Qershori i vitit 2018. Faza e dytë do të filloj në fillim të vitit të ardhshëm dhe do të jetë tërheqja graduale e shfrytëzimit e kodeve ekzistuese siq janë: +377, +386, +381 dhe sipas dinamikës së parë kjo do të ndodhë deri në fund të Qershorit 2018. Ndërsa sa i përket një operimi që nuk mund ta quajmë operatori i tretë i telefonisë mobile në Kosovë, ky operator ka pasur një kusht që me marrjen e kodit të filloj edhe funksionalizimi formal i tij në Republikën e Kosovës që do të thotë me 15 Dhjetor të vitit 2016 ka filluar procesimi, por ta kemi parasysh që funksionimi i tij është shumë i limituar.

Blerim Kuqi – theksoi se vërejtjet e bëra nga auditori janë të rëndësishme dhe është dashur të merren parasysh nga Autoriteti. Sidomos përmisimin e procedurave reale dhe akteve nënligjore të brendshme është më rëndësi se çdo send tjetër për këtë agjencion dhe është dashur të realizohet nga auditori.

Kreshnik Gashi – sqaroi se statuti përfundimisht është draftuar këtë vit dhe është miratuar në bordin e ARKEP-it nga shtatori i këtij viti. Po ashtu edhe regullorja e brendshme është draftuar kështu që me këto dy akte ne e përmbushim komplet gjithë kërkesat e akteve nënligjore sa i përket ligjit dhe funksionimit tonë të brendshëm.

Kryetari – një çështje tjerë me rëndësi që është paraqitur në raportin e auditorit është rekrutimi i një të punësuar pa procedura të rekrutimit, që sipas mendimit tim është shkelje ligjore, pse dhe si ka ndodhur kjo?

Kreshnik Gashi - stafi cili rekrutohet sipas procedurave të shërbimit civil dhe kjo është respektuar nga Autoriteti, por për rastin në fjalë ka mundësi që është një staf jo civil që merret për qëllime të caktuara dhe për kohë të caktuara.

Kryetari – sipas të gjeturave të auditorit, rasti në fjalë që po diskutojmë nuk është punësuar me kontratë mbi vepër, por është kontratë pune për kohë të caktuar dhe ne si komision nuk duam të merremi vetëm me një punëtor por kjo është çështje që ne po e hasim në secilin agjencion, domethënë ne i kemi në total dikund 2000 punëtorë në krejt nivelin e Kosovës të cilet po dalin të tillë që po punësohen prej organizatave buxhetore të pa parapara në ligjin e buxhetit. Mua po më intereson se si dikush në agjencion e bënë një punë të tillë e kontraktin dikënd me kohë të caktuar jashtë paraplanifikimit buxhetore, a bëni ju diqka si Bord, sepse ne si komisionë me ju kemi punë?

Kreshnik Gashi – ne mundohemi të respektojmë të gjitha ligjet që ekzistojnë dhe ne ndërmarrim masa të ndryshme në bazë të dëshmisë. Ne gjithashtu kemi parë edhe raportin e auditorit e kemi trajtuar dhe në këtë rast janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në varshmëri të rekomandimeve. Për mendim tonin ka pasur hapësirë ligjore dhe ka raste të caktuara se ku mundë të merret nga dikush që nuk është staf civil e kryen një punë të caktuar.

Enver Hoti – zotëri Gashi po e përsëritë disa herë se jeni të dëmtur si autoriteti dhe bëtë një krahasim me autoritetet tjera të rajonit, por nuk e di se si po i merrni këto krahasime. Sinqerisht është çështje me kuptud përtej asaj që ju po e thoni se është njëfarë bindje në plotësim të njerëzve që ju i jepni si ndihma të domosdoshme me qenë aty.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2017

Kryetari - Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2017 përmban të dhëna për shpenzime të kuvendit për këtë periudhë, sipas programeve deputetët e kuvendit, administrata e kuvendit dhe stafi mbështetës politikë si dhe kategorit kryesore ekonomike si dhe krahasimet me buxhetet e planifikuara dhe shpenzimeve. Shpenzimet e Kuvendit për nëntëmuajorin e vitit 2017 në total janë 5 milionë euro apo 69.6% e planifikimeve.

Ismet Krasniqi – totali i shpenzimeve të buxheti për këtë periudhë, siç e tha kryetari është 69.6% dhe atë për paga dhe mëdite 100%, mallra dhe shërbime 46.64%, shpenzime komunale 75.5%, subvencione

dhe transfere 71.23%, shpenzimet kapitale është shpenzim minimal shumë të vogël 1.3% dhe në këtë kategori kemi një ngecje shumë të theksuar e cila ka qenë sipas dy faktorëve: në radhë të parë një numri të tyre procedurat është dashur të kryhen përmes Agjensionit Qëndror të Prokurimit të ashtuquajtur prokurim të centralizuar, ndërsa të një numri tjetër të prokurimeve kanë dështu për fatin e mungesës së ofertave të përgjithshme dhe mungesës së paraqitjes së operatorve ekonomik. Më pas sekretari foli për projektet kapitale veq e veq dhe për shkaqet që kanë ndikuar në mosrealizimin e tyre. Duke u barazuar në kërkesën e Ministrisë së Financave të datës 16 nëntor për deklarimin e kursimeve të mundshme për kategoritë ekonomike ne kemi deklaruar kursime, si në paga dhe mëditje 189,000 euro, për mallra dhe shërbime 139,000 euro dhe shpenzime kapitale 723,000 euro.

Enver Hoti – nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2016, këtë viti i bie që Kuvendi ka qenë jo shumë aktivë, por megjithatë për karburantin për vetura ka një ngritje për periudhën kohore raportuese krahasur me periudhën e njëjtë të vitit 2016. E njëjta qendron edhe me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, që kanë shënuar rritje krahasuar me periudhën raportues të vitit paraprak. Është shqetësuese ajo që raportuat se në mosrealizimi e investimeve kapitale kanë ndikuar ofertat e papërgjegjshme dhe mungesa e interesimit të operatorëve. Ne dijmë që kemi njerëz zakonisht të firmave, kompani të regjistruar të cilat kryejn shumë punë të kësaj natyre në gjithë vendin dhe është diçka jo në rregull kur kompanit ankohen se nuk kanë punë, mjetet janë të zotume thirrjet janë sigurisht me procedura të rregullta dhe pse nuk aplikojnë ose pse paraqiten vetëm aplikantët që nuk janë të përgjegjshëm.

Ismet Krasniqi – sa i përket shpenzimeve të udhëtimit janë edhe si rezultat i disa aktiviteteve shumë të rëndësishme të Kuvendit dhe në radhë të parë ka qenë shënimi i 17 shkurtit - ditës së pavarësisë ku kemi pasur musafir edhe nga Japonia dhe nga vendet e caktuara të botës që të gjithë ata persona të ftuar me vendim të Kryesisë së Kuvendit, janë paguar biletat për ta. Sa i përketë derivateve për vetura në fund të materialit keni pasqyrën për gjitha veturat veç e veç se sa janë shpenzuar dhe ne kemi identifikuar se kush ka shpenzuar duke filluar prej Kryetarit Kuvendit, antarëve të Krejës, këshilltarve të kryetarit dhe të administratës dhe çdo udhëtim është i mbuluar me një dëshmi përcjellëse. Sa i përket çështjes së mos interesimit të operatorve, kemi raste ku për një aktivitet 24 persona kanë shkarkuar dosjen e tenderit për paisje deri në 10000 euro ditën e mbylljes së tenderit nuk ka ardhë asnjë person. Për çdo tender që shpallet edhe për dilemat që kanë operatorët në kërkese të aplikimit të tenderit mund të kërkojnë sqarime shpesh nga drejtorja e prokurimit dhe askush nuk ka ardhë nuk kanë shprehur ndonjë shqetësim.

Enver Hoti – sa i përket shpenzimeve për karburante të veturave unë e kam marrë këtë përgjigje dhe në vitet e kaluara kur është raportur për shpenzimet e kuvendit, dhe nuk dyshoj asnjëherë se ju si administratë nuk e keni përcjell me procedura, por kam problem tek arsyeshmëria e përdorimit të automjeteve, kur dihet që Kuvendi nuk ka qenë aktiv për kohë të gjatë në vitin 2017.

Ismet Krasniqi – sqaroi se Kryesi e Kuvendit ka filluar të jetë në punë deri më datën 3 gusht, apo deri në datën kur është bërë betimi i deputetëve së legjislaturës së gjashtë.

Ali Lajçi – pyeti se sa është humbja dhe rënia e buxhetit në total të shpenzimeve, që nuk mund të shpenzohet për shkak të afateve?

Ismet Krasniqi – siç theksova edhe më lartë, sipas kërkesës së Ministrisë së financave për kursime, më 16 nëntor që të gjitha mjetet e pashfrytëzuara t'i kthejmë mbrapa, ne kemi deklaruar kursime në paga dhe mëditje 189,000 euro, për mallra dhe shërbime 139,000 euro, dhe shpenzime kapitale 723,000 euro.

Lumir Abdirxhiku – theksoi se janë disa shpenzime që besoj se do kishin mund të u kursy më shumë. Tek çështja e drekave, mëditjeve dhe udhëtimeve jashtë vendit ato të deputetëve dhe të stafit administrativ sepse 90% e këtyre udhëtimeve janë në Shqipëri, Malë të Zi dhe Maqedoni, kështu që

ndoshta kishin mund me i reduktu dhe takimet të mbahen Kosovë. Është shpërputhje e madhe mes shpenzimeve, kur deputetët 90% udhëtojnë jashtë regjionit e 10% në regjion, ndërsa stafi 90% udhëtojnë në regjion e 10% jashtë regjionit, kështu që këto ju kisha lutë që me i pas pak parsysh këto shpenzime dhe mundësitë për kursime në këtë kategori. E dyta e pashë edhe tek çështja e drekave, e llogarita Kuvendi, respektivisht kabineti i kryetarit në ditë i konsumon për një drekë dikun 170 euro dhe kjo është një rrogë mesatare e një kosovari dhe iu kisha lutë që me pas një program të kursimi dhe natyrisht kjo është një temë që nuk ju takon vetëm juve, por duhet diskutohet edhe në seancë.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2017.

6. Shqyrtimi i Propozimeve të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryetari - në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, bordi i BQK-së ka emëruar panelin seleksionues për përzgjedhjen e një antari joekzekutiv të bordit. Paneli ka njoftuar se ka zhvilluar gjitha procedurat e konkursit dhe si rrjedhojë i ka propozuar Kuvendit listën me emrat e tre kandidatëve të përzgjedhur për plotësimin e pozitës së antarit joekzekutiv të BQK-së dhe emrat janë: Bedri Peci, Flamur Marsori dhe Genc Rraci. Qeveria brenda afatit ligjor prej 15 ditësh ka dërguar opinionin e saj dhe është e deklaruar se pajtohet me kandidatët e propozuar. Ne si komision vlerësojnë e i plotësojnë kushtet kandidatë dhe i rekomandojmë Kuvendit të përzgjedh njërin prej tyre si anëtar joekzekutiv të bordit të BQK-së.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë një kandidatë për pozitën e antarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, nga tre kandidatët e propozuar, si në vijim:

1. **Bedri Peci,**
2. **Flamur Mrasori,**
3. **Genc Rraci.**

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, ti dërgohet Presidentit për miratim dhe emërim në pozitën e antarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

7. Të ndryshme

Krejtari – njoftoi se në këtë pikë, i kemi dy çështje. E para me kërkesë të tyre janë ftuar në takim përfaqësuesit e institutit GAP, që të bëjnë prezantimin për një analizë të bërë lidhur me ndarjen e

subvencioneve në Kosovë. Qështja e dytë ka të bëjë me caktimin e grupeve punues për shqyrtimin e Projebtaxhetit 2018 dhe për dy projektligje tjera si komision funksional.

Berat Thaqi - theksoi se me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Institut GAP ka realizuar një hulumtim për ndarjen e subvencioneve në Kosovë në nivel qëndror dhe atë lokal. Pra fokusi i projektit ka qenë tek kualiteti i legjislacionit dhe ne nuk e kemi shiquar ndarjen e subvencioneve e rasteve specifike por vetëm legjislacionet. Sa i përket komunave që kanë qenë objekt hulumtimi, ne kemi marrë për bazë komunat të qeverisura nga partit e ndryshme politike dhe dy organizata buxhetore të nivelit qëndror që janë dy ministri.

Nora Jusufi – theksoi se për shkak se mungon një bazë ligjore e rregulluar nga ministria e financave për ndarjen e subvencioneve, ku kjo ka mbetur që çështja e ndarjes së subvencioneve të rregullohet pothuajse ekskluzivisht nga rregulloret e brendshme të organizateve buxhetore dhe kjo e ka bërë që shumë rregullore të jenë të mangta dhe cilësia e tyre të jetë shumë e dobët. Aktualisht ekziston Ligji për ndihma shtetore i cili është plotësuar këtë vit dhe ekziston rregullorja e ministris së financave mbi kriteret standarte dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, por ligji nuk është plotësuar me akte nënligjore dhe rregullorja i përjashton kategoritë e tjera siq janë subjektet politike, private dhe personat fizik.

Gjetjet kryesore tonat për sa i përket rregullove të ndarjes së subvencioneve janë: mungon një përkufizim unifom i subvencioneve në nivel lokal dhe qëndror dhe disa prej rregulloreve nuk e kanë definuar termin definicion, pastaj është një numër i konsiderushëm i rregulloreve që nuk e detyrojnë publikimin e thirrjeve për aplikimit në faqën zyrtare të institucioneve gjegjëse ose mediumet tjera, nuk i obligojnë as publikimin e formularve për aplikim dhe të listeve të përfituesve sipas emrit për shumën në mënyrë që të menjahet konflikti i interesit dhe keqmenaxhimi i fondeve publike. Afatet për shqyrtimin e ankesave të aplikantëve jopërfitues janë të ndryshme në secilat rregullore që kemi shqyrtuar dhe shumë prej tyre as nuk vendosin afate për shqyrtimin e ankesave të mundshme, përbërja e komisioneve në vlersime nuk është e detajuar për sa i përket numrit të anëtarve që mund ti ketë, nëse duhet të ketë përfaqësime të barabartë gjinor dhe nuk konsiderohet fare pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm gjë që mund të minimizojë transparencë në ndarjen e subvencioneve. Megjithatë të gjitha rregulloret kanë përcaktuar disa kategori apo fusha përmes cilave japin subvencione, kriteret sipas kategorive më shumë i ngjajnë nënkategorive se sa një kriteri dhe kjo lënë hapsirë për gjykimet subjektive, shuma maksimale dhe minimale e subvencioneve që duhet tu jepet përfituesve përfshihet në secilin rregullore, por asnjëra prej këtyre nuk është e përcaktuar në bazë të kriterve dhe janë të përcaktuara vetem si shifra, pa dhënë ndonjë sqarim.

Numri i kufizimeve të marrjes së subvencioneve nga e njejta subjekt brenda një periudhe një vjeqare ekzistonë disa komuna po flitet vetëm në rastet e përfituesve të ndihmës shëndetësore apo sociale por kjo nuk është e sqaruar sa duhet dhe disa komuna nuk kanë kufizime të tilla që qojnë tek zgjedhja e përfituesve të njëjtë vazhdimisht brenda një periudhe një vjeqare.

Sa i përket zbatimit të një rregullorje në praktik, një nga problemet kryesore është se raportet financiare nga përfituesit nuk mblidhen për tu siguruar që paratë janë përdorur sipas qëllimit, pastaj subvencionet ka raste që janë aprovuar nga kryetaret e komunave edhe në raste kur është kaluar kufizimi i shumës maksimale për të cilën kryetari mund të aprovoj e këtë gjë duhet ta bëjë vetem Komiteti për Politik dhe Financa i Kuvendit Komunal. Përfituesit e njejtë përfshirë kompani apo organizata të mëdha kanë përfituar disa herë, gjithashtu ka raste edhe kur bizneset subvencionohen edhe në raste kur nuk përfshihen subvencionimi i tyre në rregullore.

Udhëzuesin që kemi hartuar nga hulumtimi, përveç që ofron rekomandime për definiminin e subvencioneve si term të përgjithshëm apo sipas fushës së subvencionuar po ashtu ka edhe rekomandime rreth përbërjes së formave për aplikim, kriterëve për shumën e ndarjes së subvencioneve, rreth përbërjeve së komisioneve vlerësuese dhe po ashtu propozon kthimin e komisioneve monitoruse. Ndër të tjera ne besojmë që udhëzuesi do të ndihmonte në rritjen e cilësisë së këtyre rregulloreve është

një pikë fillestare e mirë për hartimin e disa kriterëve bazë për ndarjen e subvencioneve dhe ne rekomandojmë në mbështetjen tuaj, që të kërkoj nga ministria e financave që në krijimin e një baze të përgjithshme ligjore që do të siguronte që të gjitha organizatat buxhetore të përbushen së paku kriteret minimale të cilësisë dhe rregulloreve për ndarje buxhetore të subvencioneve.

Neser Osman – është shqetësuese se ka ndarje të subvencioneve të pakontraktuara, se na subvencionet më tepër i kuptojmë këto fusha ku kërkohet para më shumë tek ministria e bujqësisë, e arsimit.

Berat Thaqi – ne mendojmë se duhet të ketë një legjislacion me anë të cilave rregullohen kriteret e të dhënave të subvencioneve. Nëse shohim këto rregulla administrative për rregulloret e komunave nga organizatat buxhetore ka një laramani të madhe në mungesë të kriterëve. Ideja jonë është që ministria e financave është dashtë ti përcaktoj kriteret minimale edhe nën ato kriterë mos me pas asnjë rregullore për subvencione qoftë institucionet lokale apo qendrore.

Lumir Abdirxhiku – pyeti a bëhet fjalë për ndryshime ligjore apo udhëzim administrativ brenda ministrisë?

Berat Thaqi – për momentin nuk ka ndonjë ligj që rregullon këto kriterë për këtë arsye kjo ka metë të rregullohet në akte nënligjore dhe për këtë arsye kemi këtë laramani të madhe. Nëse ministria e financave do kishte nxjerrë një udhëzim administrativ apo një draftligj i cili përcakton kriteret minimale si në këto fushë.

Blerim Kuçi – ndoshta është momenti më i mirë të mendojmë për këto çështje edhe pse ka një avancim në këtë drejtim. Në kohën se sa kam qenë kryetar komune nuk besoj se ndonjë komunë ka pas ndonjë rregullore të caktuar për qështjen e subvencioneve, ndërsa tani ka avansim dhe kjo na shtynë me mendu edhe më tutje për me rregullue këtë çështje. Nuk ekziston një ligj që rregullon këtë fushë dhe si rezultat i mungesës së ligjit, ajo është pjesë e menagjimit duke u bazu në akte nënligjore që dalin nga asamblëet komunale. Së paku qfarë duhet bërë është me i detyruar që rregulloret të aprovohen në asamblëet komunale, që krijohet një bazë ligjore. Qështja është se ato rregullore ku janë të aprovime, a janë të aprovime në asamble komunale, nëse nuk janë atëherë kush i ka aprovuar? Këto rregullore mund të nxjerrjen dhe aprovohen dhe të krijohet baza ligjore, ndërsa tek çështja e shpenzimeve në komuna nuk duhet ndërhyrë për shkak të specifikave që kanë komunat.

Naser Osmani – nuk mund të nxjeret asnjë akt nënligjor nëse nuk ka ekziston ligji. Tek çështja e subvencioneve e vetmja mundësi është nëse e parasheh ligji, pra mund ta vendosim në buxhet se si mund të bëhet shpenzimi i tyre.

Blerim Kuçi – problemi është këtu te standartizimit i këtyre rregulloreve sepse ligji për vetëqeverisje lokale i rregullon mundësin e nxjerrjes së tyre, po nuk ka ndonjë standard apo kornizë të caktuar të krijimit të hartimit të këtyre rregulloreve.

Ali Lajçi – unë e shiqova këtë raport mjaftë mirë dhe është një hulumtim dhe qasje të një lloji testimi dhe krahasimi mes komunave dhe menxhimit të mirë në fushën e subvencioneve. Unë po e kuptoj këtë që është një synim për ta normalizuar dhe për ta futur në një normë ligjore mënyrën e ndarjes së subvencioneve që është mëse e domosdoshme, ndërsaq se si shpenzohen ato, në dobi të shumë sektorëve, si në bujqësi apo në sektorët tjerë është çështje tjetër. Puna që keni bërë si institut duhet vlerësuar, por unë po mendoj se duhet ta kemi një udhëzues në kuadër të përbërjeve që mund të kenë ligjet.

Enver Hoti – me të vërtetë është e rëndësishme çdo e nisëm që merret për me pas rregull më shumë për menaxhimin e financave publike. Jami bindur se ligji për vetëqeversije lokale shumë mirë e trajton dhe e rregullon këtë, janë pjesë të buxhetit dhe të subvencioneve që miraton asambleja komunale. Mirëpo problemi fillon në shfrytëzimin e tyre.

Berat Thaqi – ideja është me kriju disa kriterë minimale jo me vendos kufizime të ashpra në shpenzimin e buxhetit sepse ato secilat kanë natyrat e ndryshme për zhvillim ekonomik.

Kryetari – çështja e dytë është krijimi i dy grupeve punuese për shqyrtimin e Projektbuxhetit 2018 në kuadër të komisionit. Stafi mbështetës në konsultim me mua ka përgatitur një plan të veprimit për ndarjen e grupeve për shqyrtimin e projektbuxhetit dhe kërkesave buxhetore. Propozimi është që të ndahemi në dy grupe punuese, dhe një grup punues të merret me shqyrtimin e buxhetit dhe kërkesave të ministrisë dhe agjensioneve të pavarura, ndërsa grupi i dytë kërkesat që vijnë nga komunat. Grupet punues mbajnë takime dhe dëgjime buxhetore ndaras dhe në fund përgatisin raportin me rekomandime për votim në komision. Grupe punuese për shqyrtimin e kërkesave të komunave propozojë të përbëhet nga: Safete Hadërgjonaj (kryesuese), Naser Osmani, Blerim Kuçi, Ali Lajçi, Fikrim Damka dhe Mytaher Haskuka. Ndërkaq, Grupi Punues tjetër që do të merret me shqyrtimin e buxhetit dhe kërkesave buxhetore të ministrive dhe agjensioneve të pavarura të përbëhet nga: Lumir Abdixhiku (kryesues), Jelena Bontic, Dardan Molliqaj, Enver Hoti dhe Mërgim Lushtaku.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin për caktimin e dy grupeve punuese në bazë të fushëveprimit dhe përbërjes si më lartë, të propozuar nga kryetari i komisionit.

Po ashtu Komisioni në bazë të propozimeve të kryetarit të komisionit, caktojë grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, me këtë përbërje: Dardan Molliqaj (kryesues), Jelena Bontic dhe Blerim Kuçi. Si dhe grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Ali Lajçi.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku